

Komuna e Klinës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Pas shtatë viteve të qeverisjes së Komunës së Klinës nga ana e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), zgjedhjet lokale të vitit 2007 nxorën Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) si forcën më të madhe politike në këtë komunë. Në zgjedhjet e para për kryetar komune fitues doli Sokol Bashota nga PDK. Sokol Bashota u rizgjodh kryetar komune edhe pas zgjedhjeve lokale të 2009.
2. Në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë, del se komuna e Klinës ka 38.496 banorë.¹
3. Koalicioni qeverisës në Klinë përbëhet nga PDK, LDK dhe LDD. Komuna e Klinës ka 10 drejtori. Kuvendi Komunal i Klinës përbëhet prej 27 anëtarësh, prej të cilëve nëntë ulëse i mbajnë përfaqësuesit e PDK, nëntë ata të AAK, gjashtë LDK, dy LDD dhe një ulëse PSHDK.
4. Në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2009, problemet kryesore që ka pasur në atë kohë kjo komunë kanë qenë mungesa e ujit të pijes, mungesa e stacionit të autobusëve, shërbimet e dobëta komunale, ndotja e ambientit, prezenca e mbeturinave, mungesa e ndriçimit publik dhe mungesa e parqeve.²
5. Nga hulumtimi i UNDP-së, Mozaiku i Kosovës 2012, tregohet se 64% në krahasim me mesataren e kosovarëve 69%, janë të kënaqur me punën e Kryetarit të Komunës, kurse 61% në krahasim me 63% të kosovarëve janë të kënaqur me punën e Kuvendit Komunal. Përqindje e barabartë e banorëve të Klinës me mesataren e kosovarëve 64%, janë të kënaqur me punën e Administratës Komunale.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Instituti GAP. Raporti I Komunës së Klinës I vitit 2009. Fq 7. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/37627_Klina-raporti%20komunal.pdf

Problemet kryesore të Komunës së Klinës 2013

- 1. Mungesa e ujit të pijes.** Shumica e vendbanimeve të Komunës së Klinës përballen me mungesa të gjata të ujit të pijes, duke përfshirë edhe qytetin.³ Komuna, me ndihmën e Komisionit Evropian, kanë ndërtuar fabrikën e re për gjenerimin e ujit të pijes, në vendin “Drini i Bardh”. Fabrika akoma nuk është funksionale dhe nuk ka ndonjë kohë të paraparë për funksionalizimin e saj. Gypat e ujit në zonat urbane janë të vjetër. Në disa fshatra dhe vendbanime, komuna ka instaluar gypat e ujit, por uji mungon. Këto lokalitete janë Gllarevë, Prçevë, Çupevë, Gjurqevik, Bokshiq, Grabanicë, Dollovë, Zajm, Ujmirë, Qabiq dhe Ranoc.⁴ Disa fshatra të tjerë të komunës së Klinës nuk kanë akoma rrjet të ujësjellësit, si fshati Budisalc, Stupë, Rudicë, Krushevë, Leskoc, Jagodë, Zabergjë, Zajm dhe Grebnik. Pa ujë të pijes janë edhe zonat urbane. Ndërtesat kolektive në zonën e quajtur “Rafi”, përkatësisht në rrugën “Abedin Rexha”, për dy muaj të këtij viti nuk kanë pasur ujë të pijes, ndërsa vitin e kaluar po kjo zonë është përballur për pesë muaj pa ujë të pijes. Problemin me ujë të pijes në këtë komunë e konfirmon edhe hulumtimi i zhvilluar nga UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012). Sipas këtij hulumtimi vetëm 23% e banoreve në komunën e Klinës janë të lidhur në ujësjellësin publik, në krahasim me mesataren e Kosovës 60%. Prej atyre që kanë deklaruar se janë të lidhur me ujësjellësin publik, 38% kanë ndërprerje të ujit me shumë se 11 orë në ditë, ndërsa pjesa tjetër e banorëve të Klinës kanë deklaruar se kanë ndërprerje të ujit deri në tetë orë në ditë. Sipas këtij hulumtimi, cilësia e ujit të pijshëm nga ujësjellësi publik në Klinë është shumë e ulët. Rreth 71% e familjeve që janë të lidhura me ujësjellësin publik kanë pohuar se uji i çezmës është i turbullt nga papastërtia, 49% kanë thënë se shtypja e tij është shumë e ulët për shfrytëzim shtëpiak, dhe shumica dërmuese, 78%, kanë deklaruar se uji i çezmës ka edhe shije edhe erë të keqe.⁵
- 2. Mungesa e sistemit të kanalizimit.** Problemi i dytë më i theksuar në këtë komunë është ai i mungesës së kanalizimit në shumë vendbanime. Kanalizimi mungon në 30 fshatra ku disa prej tyre janë fshatrat Binxhë, Budisalc, Deiq, Dollc, Dollovë, Dranashiq, Drenoc, Dresnik, Dugajevë, Dush, Dush i Vogël, Gjurgjevik, Grabanicë, Grabcë, Jagodë, Jashanicë, Jelloc, Kërrnicë, Klinafc, Krushevë e Madhe etj. Ne fshatin Krushevë e

³ Gazeta “Bota Sot”. 08.07.2012. Banorët e Klinës po përballen me mungesë të madhe të ujit.

Burimi: <http://www.botasot.info/lajme/176075/U0isrGo/>

⁴ Agjencia e lajmeve “Kosovalbaner”. 10 janar 2012. Burimi: <http://kosovalbaner.com/kriza-e-ujit-perfshin-klinen-e-6-fshatra-te-tij/>

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 76. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

Madhe, kanalizimet derdhen ne afërsi te pusit nga ku fshati e siguron ujin e pijes, ndërsa ne fshatin Jashanicë kanalizimet derdhen në rrugën kryesore. Hulumtimi i UNDP tregon se 73% e qytetarëve në Klinë janë shumë të pakënaqur apo të pakënaqur me gjendjen e kanalizimeve në vendbanimet e tyre.⁶

3. Gjendja e keqe e objekteve shkollore. Objektet shkollore të cilat kërkojnë riparim ose edhe rindërtim të ri janë shkollat fillore në fshatrat Perqeve, Grabanicë dhe Kpuz. Këto objekte janë të vjetruara, dyert dhe dritaret janë të dëmtuara dhe toaletet janë në gjendje jo të mirë. Në gjendje të njëjtë është edhe shkolla “Ismet Raci” në qytetin e Klinës e cila është ndërtuar në vitin 1969. Kjo shkollë ka afro 2 mijë nxënës. Shkolla në fshatin Sferë dhe në fshatin Perqeve nuk kanë sistem të ujit të brendshëm.

4. Pluhuri nga gurthyesit. Bashkëbiseduesit në këtë komunë kanë shfaqur shqetësim nga ndotja e ajrit dhe shkalla e lartë e pluhurit e cila vjen kryesisht nga prezenca e gurthyesëve. Gurthyesit janë aktiv në fshatin Gllarevë, Gremnik, Dollc, Perqeve, Volljak dhe Sferkë. Te dhenat e UNDP-së tregojnë se banorët e Komunës së Klinës janë mjaft të shqetësuar me problemet e mjedisit në komunën e tyre. Thuajse gjysma apo 46% e tyre konsiderojnë lagjen e tyre të fëlliqur ose shumë të fëlliqur, kurse 48% deklarojnë se qyteti i tyre është i fëlliqur ose shumë i fëlliqur. Ngjashëm, 20% e banorëve të Klinës pohojnë se kanë probleme me cilësinë e ajrit në afërsinë e tyre, përqindje kjo mjaft e lartë në krahasim me mesataren e Kosovës që është rreth 11%.⁷

5. Mungesa e çerdheve. Komuna e Klinës ka vetëm një çerdhe publike. Në këtë institucion pranohen gjatë një viti afro 50 fëmijë.⁸ Nevoja për çerdhe ndihet në disa zona të kësaj komune. Kësisoj, çerdhe është kërkuar nga banorët e lagjes “Arbëria”, lagjja “Tikveshi”, fshati Çabiç, fshati Caravik, fshati Siqevë, fshati Ujëmirë, fshati Volljakë.

6. Mungesa e Shtëpisë së Kulturës dhe Bibliotekës së qytetit. Komuna e Klinës nuk e ka asnjërën nga këto. Mungesa e bibliotekës vlerësohet si handicap i madh për rininë e kësaj komune. Për veç mungesës së bibliotekës së qytetit, edhe shkollat e kësaj komune përgjithësisht i kanë jo funksionale bibliotekat e

⁶ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 76. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁷ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 77. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁸ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Rubrika – Statistikat. Raporti Statistikat e Arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovës 2012/2013. Fq 5. Burimi: http://www.mashtgov.net/advCms/documents/Statistikat_e_Arsimit_neKosove_2012_13%20_1.pdf

shkollës. Ne ato shkolla ku bibliotekat funksionojnë, mungon literatura apo mungojnë tituj të ri librash. Klina nuk ka as Shtëpi të Kulturës për ushtrimin e veprimtareve kulturore.

- 7. Mungesa e nënkalimeve dhe urave.** Banoret e lagjes “Dukagjini” kanë kërkuar kalim alternativ të rrugës në formë të nënkalimit apo mbikalimit tek vendi i quajtur hekurudha që lidhë magjistralen Klinë – Prizren. Nevojë të njëjtë kanë parashtruar banorët e lagjes “Tikveshi” të cilët kanë kërkuar nënkalim në rrugën që shpije në drejtimin Skenderaj – Istog. Ndërsa në fshatin Berkovë kërkohet ndërtimi i një ure mbi lumin e fshatit i cili do të lehtësonte bujqëve kalimin më lehtë në tokat e tyre bujqësore.
- 8. Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumit “Klina” dhe “Lumëbardhi”.** Të gjitha kanalizimet fekale dhe atmosferike në Komunën e Klinës derdhen në shtratin e “Lumëbardhit” dhe lumin “Klina”. Shtrati i këtyre lumenjve shfrytëzohet edhe për hedhjen e mbeturinave të ndryshme. Shtretërit e këtyre lumenjve nuk janë mirëmbajtur në vitet e fundit, veçmas “Lumëbardhi”, ndërsa lumi Klina është rregulluar në një pjesë në qytet. Ky problem është më i theksuar në lagjen “Dukagjini” dhe në fshatrat Berkovë, Deiq, Drenoc, Dresnik dhe Dush.⁹

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur apo ruajtur


- 1. Gjetjet arkeologjike në Dresnik.** Zbulimi i një harku të madh vendbanimesh të vlerësuara të kohës Ilire në fshatin Dresnik të kësaj komune vlerësohet pasuri e veçantë arkeologjike. Bashkëbiseduesit nga kjo komunë kanë kërkuar përgjithësisht që kjo zonë të shpallet zonë e mbrojtur dhe të mos lejohen ndërtime dhe gjermime jo të autorizuar dhe komuna të investojë që ekspertet e fushës përkatëse të arrijnë të bëjnë gjermime dhe zbulime të tjera me rëndësi për Klinën dhe vendin në tërësi.
- 2. Tokat bujqësore.** Komuna e Klinës vlerësohet të ketë cilësi të mirë të tokave bujqësore të cilat rezultojnë me rendimente të mira. Nga bashkëbiseduesit është adresuar nevoja që këto hapësira të bëhet investim në ujitje (zgjerim dhe ri funksionalizim të sistemit të ujitjes) dhe ruajtjes, pa pasur mundësi të ndërtimit të objekteve afariste apo të banimit në këto hapësira.

⁹ Komuna e Klinae. Faqja Zyrtare. Rubrika lajmet. 15.03.2013. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/kline/News/Klina-ne-vershime-per-dy-dite-rresht.aspx>

Trendet Buxhetore në Komunën e Klinës

Komuna e Klinës në vitin 2013 ka 7.4 milion euro buxhet. Krahasuar me vitin 2010, buxheti i kësaj komune ka shënuar rritje prej 1.2 milion euro (20%). Në vitin 2012, të hyrat vetanake të komunës kanë qenë 719 mijë euro. Disa nga të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm¹⁰ rreth të të hyrave vetanake janë: 1) mungesa e sistemit automatik të faturimit përveç të hyrave nga tatimit në pronë; 2) mungesa e listës së detajuar të debitorëve dhe; 3) mungesa e barazimit formal mes departamenteve. Në komunën e Klinës janë të regjistruara 10.600 prona, ndërsa sipas Departamentit për Tatimin në Pronë të kësaj komune tatimpagues të rregullt janë 90% të tyre. Konsiderohet se rreth 300 prona janë të paregjistruara.¹¹

Figura 1. Buxheti i Komunës së Klinës- 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?kline/2013#/~/~kline>

¹⁰ ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Klinës Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/Kline_Report_ALB_27.6_677935.pdf

¹¹ Komuna e Klinës, Departamenti i Tatimit në Pronë, Përgjigje në Kërkesën e Institutit GAP, 15 Gusht 2013

Në bazë të grafikunit të mëposhtëm rreth ndarjeve buxhetore shohim se nga viti 2010 shpenzimet kapitale kanë pasur një trend të lehtë të rënies deri në vitin 2012.

Figura 2. Trendet e ndarjeve buxhetore 2010-2013



Komuna e Klinës planifikon të rris buxhetin e saj me rreth 565 mijë euro në vitin 2016 (krahasuar me 2013) dhe kjo rritje vlerësohet të vie në pjesë të madhe nga rritja e grantit qeveritar. Bie në pah se kategoria e pagave dhe mëditjeve është ajo e cila do të ketë rritjen më të madhe me 216 mijë euro, ndërsa shpenzimet kapitale do të rriten për rreth 109 mijë euro.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve 2014-2016

Të hyrat	2014	2015	2016
Të Hyrat Totale	7.642.533	7.849.502	8.015.012
Të hyrat vetanake	840.000	865.200	882.504
Grantet	6.802.533	6.984.302	7.132.508
Shpenzimet Total	7.642.533	7.849.502	8.015.012
Pagat dhe Mëditjet	4.436.364	4.556.505	4.652.581
Mallrat dhe Shërbimet dhe Komunalitë	782.500	803.627	825.325
Subvencionet dhe Transferet	80.000	82.166	83.898
Shpenzimet Kapitale	2.343.669	2.407.204	2.453.208

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Klinës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012). Në përpilimin e këtij raporti, Instituti GAP është bazuar edhe në të dhënat e siguruara nga OJQ "KOHA" në Klinë.



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.